



FLET PËR "EPOKËN E RE", ILIR IBRAHIMI IFAQE 4-5



# LV-ja DUHET TA NDËRTOJË KONSENSUSIN PËR PRESIDENTIN

Analisti politik Ilir Ibrahim ka deklaruar se Lëvizja Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve duhet ta ndërtojë konsensusin për zgjedhjen e presidentit të ri. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se edhe partitë opozitare e kanë përgjegjësinë tyre për arritjen e konsensusit të nevojshëm. Sipas Ibrahimit, për arritjen e këtij konsensusi të gjitha subjektet politike duhet të bëjnë kompromise. Ai ka treguar se mosarritja e një marrëveshje politike ndërmjet partive politike për çështjen e presidentit mund ta çojë vendin në zgjedhje të reja. Ibrahimit ka thënë se vendi ka nevojë për një qeveri stabile e jo për zgjedhje të reja

# MBROJTJA E VESELIT KËRKON TË HEDHEN POSHTË AKUZAT E BAZUARA EKSKLUZIVISHT NË TË DREJTËN ZAKONORE NDËRKOMBËTARE

Mbrojtja e Kadri Veselit ka paraqitur mocion para gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Speciale, duke sfiduar juridiksionin e kësaj gjykate. Sipas mbrojtjes, Gjykata Kushtetuese nuk e ka shqyrtuar Ligjin e Dhomave të Specializuara në vetvete, por amendamentin e propozuar i cili do ta lejonte Kuvendin t'i krijonte Dhomat e Specializuara. Mbrojtja e Veselit ka vënë në pah se as në nenin 162 të Kushtetutës

dhe as në shkëmbimin e letrave ndërmjet ish-presidentes Atifete Jahjaga dhe ish-përfaqësueses së lartë të BE-së, Catherine Ashton, nuk i referohet mundësisë që Dhomat e Specializuara do të funksiononin në bazë të një ligji të zbatueshëm të veçantë. Në këtë kontekst, mbrojtja e Veselit ka kërkuar të hedhen poshtë akuzat e bazuara ekskluzivisht në të drejtën zakonore ndërkombëtare IFAQE 3



## OPINION

SHTETI SHQIPTAR  
NUK MUND TË HESHTTE  
PARA NGJARJEVE  
TË VITIT 1981 F. 11

Shkruan:  
Bedri ISLAMI



## AKTUALE



MBESIN NË FUQI MASAT  
E NJËJTA KUNDËR COVID-19 F. 7

TË HËNËN MBAHET SEANCA  
KONSTITUTIVE E KUVENDIT,  
REGJISTRIMI I DEPUTETËVE  
MË 17 MARS F. 7

VENDOSJET GURTHEMELI PËR  
NDËRTIMIN E ÇERDHES NË  
DRENAS F. 6

## EKONOMI

OYTETARËVE U KËRKOHEM TË  
APLIKOJNË PËR LEGALIZIMIN E  
NDËRTIMEVE F. 9

IFC-ja MBËSHTET RIMËKËMBJEN  
E SEKTORIT TË PRODHIMTARISË  
NË BALLKANIN PERËNDIMOR F. 8

TRANSPORTI, DJEGIET DHE  
INDUSTRIA, NDOTËSIT MË TË  
MËDHENJ TË AJRIT NË KOSOVË F. 9

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## ShBA-ja bën thirrje për fuqizimin e lidhjeve me Japoninë

WASHINGTON, 16 MARS - Shtetet e Bashkuara po bëjnë thirrje për fuqizimin e lidhjeve ekonomike dhe të sigurisë me Japoninë. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, dhe ai i mbrojtjes, Lloyd Austin, kanë nisur një turne në Japoni dhe Korenë Jugore. Vizita pason pas një samiti online të mbajtur javën e kaluar mes liderëve të Shteteve të Bashkuara, Japonisë, Australisë dhe Indisë. Temat e diskutimeve të zyrtarëve të lartë amerikanë do ta përhijojnë lirinë e lundrimit në detet e Kinës Jugore dhe

Lindore, çështjen bërthamore të Koresë së Veriut dhe situatën në Mianmar, pas grushtshtetit ushtarak. "Marrëdhëniet ekonomike midis Shteteve të Bashkuara dhe Japonisë janë, siç e dini, një nga më të fuqishmet në botë", u tha Blinken një grupi udhëheqësish të biznesit japonez. Sekretari Blinken vuri në pah dobësitë në zinxhirët e furnizimit global që janë shpërfaqur gjatë pandemisë së Covid-19. Ai bëri thirrje që vendet të punojnë për të krijuar zinxhirë më të mirë të

furnizimit në të ardhmen. Koreja e Veriut ka të ngjarë të jetë në krye të rendit të ditës pasi Shtëpia e Bardhë tha se ky vend, deri më tani, kishte kundërshtuar përpjekjet e Shteteve të Bashkuara për t'u përfshirë në dialog. Në hapjen e takimit dypalësh me ministrin e Jashtëm të Japonisë, Toshimitsu Motegi, Blinken tha se ai dëshironte të punonte me Japoninë dhe aleatët për denuklearizimin e Koresë së Veriut. Blinken dhe Austin do të udhëtojnë nga Tokio në Seul



më 17 mars dhe do të zhvillojnë në kryeqytetin e Koresë së bisedime me homologët e tyre Jugut.

## Armenia dhe Azerbajxhani tregojnë fuqinë përmes ushtrimeve ushtarake

JEREVANI, 16 MARS - Një ditë pasi Azerbajxhani nisi stërvitjet ushtarake katërditore, edhe Armenia ka filluar të martën ushtrimet ushtarake të shkallës së gjerë. Të dyja vendet, në fund të vitit të kaluar, u përfshinë në një konflikt të armatosur për rajonin e Nagorno Karabakut. Në stërvitjet e Armenisë do të marrin pjesë 7 500 ushtarë, rreth 100 tanke dhe automjete të blinduara, rreth 300 artileri dhe sisteme anti-ajrore dhe avionë. "Çdo stërvitje ushtarake ka qëllimin e qartë që ta kontrollojë



aftësinë mbrojtëse të trupave të burimeve", ka thënë dhe përdorimin e përgjithshëm zëvendësministri i Mbrojtjes i

Armenisë, Arman Sarkisian, në një konferencë për media. Sipas ekspertit ushtarak Karen Hovhannisian, veprimi i Armenisë tregon se ky vend dëshiron ta demonstrojë forcën e tij pas humbjes në Nagorno Karabak. Lufta në këtë rajon u ndal pas një armëpushimi të ndërmjetësuar nga Rusia që hyri në fuqi më 10 nëntor 2020. Armenia humbi pjesë të konsiderueshme të territorit që mbante nën kontroll. Zëdhënësjë e Ministrisë së

Jashtme ruse, Maria Zakharova, ka thënë se lojërat e luftës në Azerbajxhan nuk do ta rrezikojnë "stabilitetin dhe sigurinë në rajon". Muajin e kaluar ministri armen i Mbrojtjes, Vagharshak Harutiunian, ka pohuar se Rusia, e cila ka një bazë ushtarake në Armeni, po ndihmon Jerevanin t'i rikstrukturojë dhe t'i modernizojë forcat e armatosura. Më 26 shkurt, presidenti i Azerbajxhanit, Ilham Aliyev, ka theksuar se Rusia duhet ta ndalë ndihmën ushtarake ndaj Armenisë.

## Erdogani: Masa të reja do të vendosen nëse qytetarët nuk u përmbahen rregullave anti-Covid

ANKARA, 16 MARS - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka deklaruar se vendi i tij mund të vendosë kufizime të reja për ta frenuar përhapjen e koronavirusit të ri Covid-19 nëse qytetarët nuk u përmbahen rregullave. "Ne kemi vendosur të vazhdojmë t'i zbatojmë masat aktuale (të normalizimit) nëpër qytetet tona dhe t'i monitorojmë nga afër zhvillimet", ka deklaruar

presidenti turk. Erdogan ka paralajmëruar se kufizimet e reja janë të pashmangshme nëse qytetarët nuk u përmbahen masave parandaluese Covid-19. Në muajin janar, Turqia nisi një fushatë masive të vaksinimit kundër koronavirusit, ndërsa më 1 mars filloi një normalizim gradual nga kufizimet e

koronavirusit. Erdogan ka njoftuar se 11.5 milionë doza të vaksinës janë administruar në të gjithë vendin, prej të cilave rreth 7.94 milionë doza të para dhe rreth 3.57 milionë doza të dyta. Presidenti turk ka theksuar se vendi do të vazhdojë të marrë vaksina nga jashtë derisa vaksina e saj e zhvilluar në vend do të jetë gati për përdorim.



## Somali, rreth 2,5 milionë personave u nevojitet ndihmë humanitare



MOGADISHU, 16 MARS - Qeveria somaleze ka njoftuar se 2,5 milionë personave në këtë vend u nevojitet ndihmë humanitare për shkak të pandemisë së Covid-19, sulmeve terroriste dhe katastrofave humanitare. "Pandemia e koronavirusit,

problemi me ujë të pijshëm, përmytjet dhe terrorizmi janë mes sfidave kryesore për Somalinë", ka theksuar ministrja somaleze për Çështje Humanitare dhe Menaxhim të Katastrofave, Khadija Diriye. Ministri somalez i Financave,

Abdirahman Duale Beileh, ka theksuar se Organizata për Bashkëpunim Islam (OIC), Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore pozitivisht iu përgjigjën thirrjeve qeveritare për ndihmë. Zyra për Koordinim të

Çështjeve Humanitare e Kombeve të Bashkuara (OCHA) ka paralajmëruar se tensionet politike në Somali kanë shkaktuar krizë humanitare në vend dhe, sipas kësaj zyre, 800 000 persona doemos duhej të migronin.

# Mbrojtja e Veselit kërkon të hedhen poshtë akuzat e bazuara ekskluzivisht në të drejtën zakonore ndërkombëtare

Mbrojtja e Kadri Veselit ka paraqitur mocion para gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Speciale, duke sfiduar juridiksionin e kësaj gjykate. Sipas mbrojtjes, Gjykata Kushtetuese nuk e ka shqyrtuar Ligjin e Dhomave të Specializuara në vetvete, por amendamentin e propozuar i cili do ta lejonte Kuvendin t'i krijonte Dhomat e Specializuara. Mbrojtja e Veselit ka vënë në pah se as në nenin 162 të Kushtetutës dhe as në shkëmbimin e letrave ndërmjet ish-presidentes Atifete Jahjaga dhe ish-përfaqësueses së lartë të BE-së, Catherine Ashton, nuk i referohet mundësisë që Dhomat e Specializuara do të funksiononin në bazë të një ligji të zbatueshëm të veçantë. Në këtë kontekst, mbrojtja e Veselit ka kërkuar të hedhen poshtë akuzat e bazuara ekskluzivisht në të drejtën zakonore ndërkombëtare

PRISHTINE, 16 MARS - Mbrojtja e ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe PDK-së, Kadri Veselit, ka paraqitur mocion, me anë të të cilit ka sfiduar juridiksionin e Gjykatës Speciale mbi bazën se Ligji i Dhomave të Specializuara është "ultra vires" dhe ka shkelur thelbësisht parimin e ligshmërisë, duke e kthyer Specialen në një gjykatë të jashtëzakonshme de facto, në krahasim me një të specializuar, që shkel nenin 103 (7) të Kushtetutës.

Sipas mbrojtjes, Gjykata Kushtetuese nuk e ka shqyrtuar Ligjin e Dhomave të Specializuara në vetvete, por amendamentin e propozuar i cili do ta lejonte Kuvendin t'i krijonte Dhomat e Specializuara. "Me fjalë të tjera, ai vlerësim paraprak i fazës së Gjykatës Kushtetuese nuk ishte informuar nga niveli i juridiksionit të Dhomave të Specializuara në të ardhmen", është thënë në mocion. Sipas mbrojtjes, askund, as neni 162 i Kushtetutës, as shkëmbimi i letrave ndërmjet ish-presidentes Atifete Jahjaga dhe ish-përfaqësueses së lartë të BE-së, Catherine Ashton, nuk i referohet mundësisë që Dhomat e Specializuara do të funksiononin në bazë të një ligji të zbatueshëm të veçantë. "Përkundrazi, referencat e vetme kanë të bëjnë me çështjet procedurale dhe sigurinë se Rregullat e Provave do të udhëhiqen nga Kodi i Procedurës Penale i Kosovës", është thënë më tutje në këtë mocion.

Mbrojtja e Veselit pretendon se tani ekzistojnë arsye të arsyeshme që Paneli i Gjykatës Kushtetuese të rishikojë këtë gjetje. "Larg nga të qenit një pyetje teorike, natyra e Dhomave të Specializuara dhe përputhshmëria e juridiksionit

të saj me Kushtetutën e Kosovës janë pengesa konkrete ligjore për të drejtat kushtetuese të z. Veseli për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa shmangie të jashtëzakonshme dhe arbitrare të procedurave të tilla si ato të caktuara në mocionet paraprake të mbrojtjes së z. Veseli për ta sfiduar juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe aktakuzën", është thënë në mocion.

Më tutje, mbrojtja i ka kërkuar gjykatësit të procedurës paraprake që t'ia referojë çështjen Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për të përcaktuar nëse juridiksioni i Dhomave të Specializuara përputhet me Kushtetutën e Kosovës.

Mbrojtja ka parashtruar se Dhomat e Specializuara janë de facto një gjykatë e jashtëzakonshme, në krahasim me një të specializuar dhe se, si rezultat, juridiksioni i saj shkel nenin 103 (7) të Kushtetutës. Sipas tyre, sipas Komisionit të Venecias, fakti që një gjykatë e themeluar për të gjykuar një numër të kufizuar çështjesh është një tregues i fortë se një gjykatë e tillë është, në fakt, e natyrës së jashtëzakonshme. "Në rastin e Dhomave të Specializuara, ligji shprehet hapur në nenin 1, që qëllimi i tij është t'i ndjekë penalisht pretendimet e përfshira në Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës 2011 të z. Dick Marty. Ligji për KSK-në nuk është as i përgjithshëm dhe as abstrakt. Është unike dhe e pashembullt në historinë e drejtësisë moderne penale që një i akuzuar të jetë një nga arsyet e miratimit të ligjit", është thënë në mocion. Mbrojtja e Kadri Veselit ka thënë se me fjalë të tjera, Dhomat e Specializuara janë krijuar posaçërisht për të ndjekur penalisht një sërë çështjesh të përcaktuara dhe për këtë arsye të



të akuzuarve, përfshirë Veselin, ndër të tjera. Po ashtu, mbrojtja e Veselit ka theksuar se Gjykata Speciale pretendon të jetë një gjykatë plotësisht vendëse, megjithatë të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe personeli i saj janë ndërkombëtarë. "Procedura e emërimit të gjyqtarëve jo vetëm se devijon nga procedurat normale të përcaktuara në Kapitullin VII të Kushtetutës, por gjyqtarët e KSK-së nuk kanë asnjë lidhje zyrtare institucionale me gjyqësorin kosovar", është thënë në mocion.

Në fund të mocionit është thënë se mbrojtja e Veselit i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake që urgjentisht ta referojë çështjen në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për të përcaktuar nëse kjo gjykatë është kompetente për t'i gjykuar veprat penale të pretenduara kundër Veselit në një proces të drejtë dhe të paanshëm, të lirë nga ndikimi i jashtëm politik dhe bazuar në ligjin e brendshëm të Kosovës, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Ndryshe, më 9 nëntor, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihën në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Selimi më 11 nëntor. Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më

26 tetor 2020. Sipas akuzës së ngritur, së paku midis marsit 1998 deri në shtator 1999, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët kishin qëllimin e përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë. "Ndër këta kundërshtarë përfshiheshin persona që ishin, ose që konsideroheshin se kishin qenë: (a) bashkëpunëtorë ose të lidhur me forca, zyrtarë ose institucione shtetërore të RFJ-së, ose që (b) ndryshe nuk mbështetnin qëllimet ose metodat e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së, ndër të cilët, persona të lidhur me LDK-në dhe serbë, romë dhe persona të kombësive të tjera (bashkërisht, 'kundërshtarët'). Ky qëllim i përbashkët përfshinte krimet e përndjekjes, burgosjes, arrestimit dhe ndalimit arbitrar ose të paligjshëm, akte të tjera çnjerëzore, trajtimin mizor, torturën, vrasjen dhe zhdukjen me forcë të personave", është thënë në aktakuzë.

Më tutje, në aktakuzë përmenden edhe Azem Syla, Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Rustem Mustafa, Shukri Buja, Latif Gashi dhe Sabit Geci. "Ndër

anëtarët e tjerë të 'ndërmarrjes kriminale të përbashkët' ishin Azem Syla, Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Rustem Mustafa, Shukri Buja, Latif Gashi dhe Sabit Geci, si dhe disa udhëheqës të tjerë politikë dhe ushtarakë të UÇK-së dhe QPK-së, ndër të cilët edhe anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm; ministra dhe zëvendësministra të QPK-së; komandantë të zonave të UÇK-së, zëvendëskomandantë të zonave dhe anëtarë të tjerë të shtabeve të komandave të zonave; komandantë të brigadave dhe njësiteve; komandantë dhe anëtarë të shërbimeve policore dhe të zbulimit të UÇK-së dhe QPK-së; ushtarë të tjerë të UÇK-së dhe zyrtarë të tjerë të QPK-së; si dhe të tjerë që vepronin në emër të UÇK-së dhe QPK-së (së bashku me Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin, bashkërisht, 'anëtarët e NKP-së'). Të gjithë këta individë, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kontribuan për arritjen e qëllimit të përbashkët. Si alternativë, disa ose të gjithë këta individë nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët, por u përdorën nga anëtarë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët për të kryer krime për realizimin e qëllimit të përbashkët (së bashku me anëtarët e NKP-së, bashkërisht 'anëtarët dhe instrumentet e NKP-së'), është thënë në aktakuzë.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, ILIR IBRAHIMI

## LV-ja duhet ta ndërtojë konsensusin për presidentin

Analisti politik Ilir Ibrahim ka deklaruar se Lëvizja Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve duhet të ndërtojë konsensusin për zgjedhjen e presidentit të ri. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se edhe partitë opozitare e kanë përgjegjësinë tyre për arritjen e konsensusit të nevojshëm. Sipas Ibrahimit, për arritjen e këtij konsensusi të gjitha subjektet politike duhet të bëjnë kompromise. Ai ka treguar se mosarritja e një marrëveshje politike ndërmjet partive politike për çështjen e presidentit mund ta çojë vendin në zgjedhje të reja. Ibrahimit ka thënë se vendi ka nevojë për një qeveri stabile e jo për zgjedhje të reja

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 16 MARS** - Analisti politik Ilir Ibrahim ka bërë me dije se për zgjedhjen e presidentit të ri të gjitha partitë politike duhet të bëjnë kompromise. Ai ka deklaruar se Lëvizjes Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve të 14 shkurtit i takon të ndërtojë këtë konsensus politik. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se subjektet politike duhet të heqin dorë nga praktika e kaluar e bllokimit për çështje nacionale. “LV-ja duhet

të jetë subjekti që duhet ta ndërtojë konsensusin e duhur dhe të nevojshëm për t'i formuar institucionet bazuar në mandatin e marrë nga votuesi. Edhe partitë e tjera kanë përgjegjësinë tyre për arritjen e konsensusit të nevojshëm. Duhet të ketë një frymë kompromisi të gjithëve. Nëse vazhdohet me qëndrimin ‘ja si them unë, e askush tjetër’ kam frikë se do të vazhdohet me përvojën e së kaluarës e cila është karakterizuar vetëm nga bllokimi dhe asnjëherë nga kompromisi”, ka thënë Ibrahimit.

Ai ka treguar se mosarritja e një marrëveshje politike në mes të partive politike për çështjen e presidentit mund ta çojë vendin në zgjedhje të reja. “Kjo pa dyshim se është e dëmshme për vendin sepse mund të na çojë sërish në zgjedhje. Në kohën kur vendi ka nevojë për një qeveri me mandat të plotë për t’u përballur me sfidat që kemi përpara, nuk e kemi luksin të vazhdojmë të qeverisemi nga një qeveri kujdestare e cila nuk e ka as mandatin e as motivin për t’u marrë me këtë situatë”, është shprehur Ibrahimit. Ai ka vlerësuar se qëndrimet

fillestare të opozitës mund të tejkalohen. “Deklarimet që kemi parë dje, mendoj se janë fillestare të cilat me një qasje proaktive dhe konstruktive mund të tejkalohen. Rolin kyç këtu e ka fituesi i zgjedhjeve”, ka thënë ai. Sipas Ibrahimit, LV-ja i ka numrat e mjaftueshëm për ta formuar qeverinë e re. “Bazuar në rezultatin zgjedhor dhe deklaratimet e disa subjekteve të pakicave, koalicioni fitues i ka votat e nevojshme për formimin e qeverisë dhe këtë duhet ta bëjë sa më parë. LV-ja ka marrë një mandat të qartë nga votuesi për të qeverisur dhe kjo duhet të jetësohet pa vonesë. Tanimë kemi parë thirrjen e seancës konstituive dhe do të ishte mirë që në të njëjtën ditë të votohej edhe qeveria”, ka thënë Ibrahimit.

**“Epoka e re”:** Z. Ibrahimit, më 22 mars është thirrur seanca konstitutive e Legjislaturës së VIII e Kuvendit të Kosovës. Besoni se fituesi i zgjedhjeve i ka votat e mjaftueshme që pa

ndonjë koalicion ta formojë qeverinë e re?

**Ibrahimit:** Bazuar në rezultatin zgjedhor dhe deklaratimet e disa subjekteve të pakicave, koalicioni fitues i ka votat e nevojshme për formimin e qeverisë dhe këtë duhet ta bëjë sa më parë. LV-ja ka marrë një mandat të qartë nga votuesi për të qeverisur dhe kjo duhet të jetësohet pa vonesë. Tanimë kemi parë thirrjen e seancës konstituive dhe do të ishte mirë që në të njëjtën ditë të votohej edhe qeveria.

**“Epoka e re”:** Z. Kurti dhe znj. Osmani kanë filluar takime konsultative me subjektet politike për çështjen e presidentit. Sa e vështirë do të jetë për fituesit ta zgjedhin presidentin e ri?

**Ibrahimit:** Fatkeqësisht, pozita e presidentit në Kosovë vazhdon të shihet si pozitë e cila duhet të dalë si rezultat i marrëveshjeve politike dhe jo si një pozitë konsensuale tej partiake. Nisur nga përvoja e kaluar, kur partitë



qëndrimin "ja si them unë e askush tjetër" kam frikë se do të vazhdohet me përvojën e së kaluarës e cila është karakterizuar vetëm nga bllokimi dhe asnjëherë nga kompromisi.

**"Epoka e re":** LDK-ja ende nuk e ka bërë të qartë qëndrimin për këtë çështje. Cili mendoni se duhet të jetë pozicioni i kësaj partie në raport me kandidaturën e znj. Osmani për presidente?

**Ibrahimi:** LDK-ja tanimë ka një leadership të ri të cilit i duhet dhënë kohë për t'u konsoliduar. Unë pres si nga LDK-ja, ashtu edhe partitë e tjera, të ndërtojnë një gjuhë dhe qasje konstruktive për çështje që i prekin interesat e vendit. Sot nuk është interes i vendit që të shkohet në zgjedhje. Nëse të gjithë pajtohen me këtë, dhe nëse përmes një bashkëbisedimi konstruktiv arrijnë të ndërtojnë një platformë për arritjen e kompromiseve të nevojshme, atëherë mendoj se edhe zgjedhja e presidentit, por edhe çështje të tjera mund të arrijnë pajtimin e nevojshëm. E ritheksoj edhe një herë, në demokraci të gjithë duhet të jenë të gatshëm për kompromis në favor të interesit madhor.

opozitare kanë bërë gjithçka për të penguar apo pamundësuar zgjedhjen e presidentit, kemi shenja që edhe këtë herë do të mungojë një konsensus. Kjo padyshim se është e dëmshme për vendin sepse mund të na çojë sërish në zgjedhje. Në kohën kur vendi ka nevojë për një qeveri me mandat të plotë për t'u përballur me sfidat që kemi përpara, nuk e kemi luksin të vazhdojmë të qeverisemi nga një qeveri kujdestare e cila nuk e ka as mandatin e as motivin për t'u marrë me këtë situatë.

**"Epoka e re":** PDK-ja dhe AAK-ja kanë bërë të qartë qëndrimet e tyre për çështjen e presidentit. Si i keni parë deklaratimet e tyre?

**Ibrahimi:** Deklarimet që kemi parë dje, mendoj se janë deklarime fillestare të cilat me një qasje proaktive dhe konstruktive mund të tejkalohen. Rolin kyç këtu e ka fituesi i zgjedhjeve. LV-ja duhet të jetë subjekti që duhet ta ndërtojë konsensusin e duhur dhe të nevojshëm për t'i formuar institucionet bazuar në mandatin e marrë nga votuesi. Edhe partitë e tjera kanë përgjegjësitë e tyre për arritjen e konsensusit të nevojshëm. Duhet të ketë një frymë kompromisi të të gjithëve. Nëse vazhdohet me

**"Epoka e re":** Deri më tani fituesit e zgjedhjeve të 14 shkurtit nuk janë deklaruar qartë rreth hapjes së Ambasadës së Kosovës në Jerusalem. Pse mendoni se përdodh kjo?

**Ibrahimi:** Politika e jashtme asnjëherë nuk do të duhej të bëhej pjesë e luftës së brendshme politike. Fatkeqësisht, edhe në këtë pikë klasa politike ka dështuar dhe vazhdon ta tregojë papjekurinë edhe këto ditë. Njohja nga Izraeli është e një rëndësie të lartë për vendin dhe nuk do të duhej të vihej as në diskutim e as në debatim. Tanimë Kosova e ka ambasadën e vet në Jerusalem dhe ajo quhet Ambasada e Kosovës dhe jo e ndonjë subjekti të caktuar politik, prandaj ajo duhet të përshëndetet dhe përkrahet nga të gjithë. Deklarimet e pamatura të cilat mund të sjellin disa "likes" në "Facebook" nuk duhet të jenë motiv i deklarimeve institucionale sepse pasojat e tyre i bart shteti dhe jo individit. Duhet të mësohemi një herë e përgjithmonë që për çështje të interesit nacional, të mos bëhet politikë partiake sepse në atë betejë nuk ka fitues sepse kur humb Kosova, humbin të gjithë.

ALBIN KURTI DHE VJOSA OSMANI KANË VAZHDUAR TAKIMET KONSULTATIVE ME KOMUNITETET

## Komunitetet joserbe do ta votojnë qeverinë Kurti

Lëvizja Vetëvendosje ka marrë mbështetjen për formimin e institucioneve të reja nga komunitetet joserbe. Përfaqësuesit e këtyre komuniteteve, pas takimit me Kurtin dhe Osmanin, kanë deklaruar se do ta votojnë qeverinë e re dhe presidentin

**"Epoka e re"**

**PRISHTINË, 16 MARS** - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, kanë pritur të martën në takimet konsultative përfaqësuesit e komuniteteve joserbe. Këta të fundit kanë deklaruar se do ta përkrahin formimin e institucioneve të reja. Të pavendosur në këtë drejtim janë vetëm deputetët e komunitetit turk.

Fikrim Damka, kryetar i Partisë Demokratike Turke, pas takimit me Kurtin dhe Osmanin, ka thënë se ai bashkë me deputeten tjetër nga radhët e këtij komuniteti do të qëndrojnë në sallë për votimin e presidentit, mirëpo bisedimet për votimin e qeverisë së re do të vazhdojnë deri të premtën. Ai ka deklaruar se ky komunitet kërkon një post ministror si dhe i ka parashtruar edhe disa kërkesa të tjera. Sipas Damkës, në takim është diskutuar edhe në lidhje me hapjen e Ambasadës së Kosovës në Jerusalem, veprim ky i kritikuar nga Turqia. "Ne do ta përcjellim këtë sfidë në qeverinë e ardhshme, por varet nga vullneti i saj si do të veprojnë për këtë çështje, por ne si dy deputetë do të jemi pranë që të ketë zgjidhje të përbashkët me BE-në, OKB-në, vendet e tjera dhe Turqinë në lidhje me ambasadën", ka deklaruar Damka.

Emilija Rexhepi, kryetare e



Partisë së Re Demokratike, ka deklaruar se do ta përkrahë Qeverinë Kurti 2, si dhe zgjedhjen e Osmanit për presidente. Rexhepi ka fituar një mandat në Kuvendin e Kosovës. Edhe deputeti i zgjedhur Elbert Krasniqi nga radhët e komunitetit egjiptian është shprehur se do të votojë qeverinë e re si dhe Vjosa Osmanin për presidente. "I takuam zonjën Osmani dhe zotin Kurti. Diskutuam për procedurat dhe hapat në vijim për krijimin e institucioneve. IRDK-ja, siç e dini, është e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës me një deputet dhe vota jonë do të jetë për krijimin e qeverisë Kurti dhe për presidenten Osmani", ka thënë Krasniqi.

Kurtit dhe Osmanit votën ia kanë premtuar edhe Qazim Rragmani nga Partia e Ashkalinjve për Integrim, kryetarja e Listës së Bashkimit

Socialdemokrat, Duda Balje dhe deputeti i VAKAT-it, Rasim Demiri. Një ditë më parë Osmani dhe Kurti kanë zhvilluar takime konsultative me krerët e Partisë Demokratike dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës lidhur me formimin e institucioneve të reja pas zgjedhjeve të 14 shkurtit. Ndërsa për të premtën është paraparë edhe takimi me kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhikun. Fituesit e zgjedhjeve të 14 shkurtit ende nuk dihet se a do të takojnë edhe deputetët e Listës Serbe e cila ka fituar 10 mandate. Pas certifikimit të rezultatit zgjedhor të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit, në të cilat partia e Kurtit ka shënuar fitore bindëse, për 22 mars është caktuar mbajtja e seancës konstituive e legjislaturës së tetë e Kuvendit të Kosovës.

## Hoxhaj vazhdon vizitat nëpër degët e PDK-së

**PRISHTINË, 16 MARS (ER)** - Në turin e takimeve që ka nisur nëpër degët e PDK-së në Kosovë, mbrëmë kryetari në detyrë i kësaj partie, Enver Hoxhaj, ka takuar kryesitë e degëve në Shtime dhe Lipjan. Ai ka treguar se kanë pasur diskutime të frytshme për rolin që do ta ketë Partia Demokratike e Kosovës si lidere e opozitës pas formimit të institucioneve. "Si çdoherë, ne do të vazhdojmë të përkushtohemi dhe të punojmë për të mirën e qytetarëve si në nivel qendror, po ashtu edhe në atë lokal. Para kryesive të këtyre



dy degëve shpreha mirënjohje për secilin anëtar dhe aktivist që është angazhuar për PDK-në

dhe vazhdon të mbetet besnik", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".

## Banorët e Shillovës në Gjilan kërkojnë mbylljen e tri lokaleve hoteliere në këtë fshat

GJILAN, 16 MARS (ER) - Komiteti për Komunitete në Gjilan ka shqyrtuar të martën një peticion të banorëve të Shillovës të cilët kërkojnë ndalimin e punës së tri lokaleve hoteliere në këtë fshat të banuar me serbë, "Ekskluziv", "Srce" dhe "Kod Seline", për shkak se po operojnë jashtë veprimtarisë së regjistruar dhe në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret komunale.

Milivoje Stojanović, këshilltar komunal, ka thënë se banorët e Shillovës janë të indinjuar me sjelljet e mysafirëve të cilët i frekuentojnë këto lokale,

duke përmendur edhe një incident me të shtëna që ka ndodhur ditët e fundit në njërin nga këto lokale.

Kapiteni i Policisë së Kosovës për regjionin e Gjilanit, Negovan Mihajloviq, ka thënë se është e vërtetë që ka prishje të rendit dhe qetësisë publike nga këto lokale dhe ky problem duhet të zgjidhet.

Shefik Surdulli ka shprehur keqardhje për shqetësimet e prezantuara të banorëve të Shillovës dhe ka kërkuar që kërkesa e tyre të trajtohet dhe të zgjidhet në kuadër të përgjegjësisë ligjore, nëse këto biznese nuk respektojnë



veprimtarinë e tyre, por pa i dhënë konotacion ndëretnik problemit, sepse nuk është i tillë.

Kemal Shahin, kryesues i Komitetit, ka pohuar se inspektorati komunal ka ndërmarrë disa herë masa

ndaj këtyre lokaleve dhe ka sugjeruar që këto lokale të mbylljen nëse kanë devijuar veprimtarinë e tyre si biznese.

Komiteti i rekomandoi Kuvendit dhe Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi që ta trajtojnë këtë problem të banorëve të Shillovës, të cilin ata e kanë adresuar tek institucionet komunale në formë të peticionit, kurse inspektorati komunal ta monitorojë gjendjen dhe t'i ndërmarrë masat e nevojshme ndaj këtyre bizneseve, nëse ato shkelin ligjin gjatë veprimtarisë së tyre.

## Prizreni bëhet me shtëpi të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara

PRIZREN, 16 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtori i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Islam Thaqi, së bashku me përfaqësuesin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Mentor Morina, kanë bërë përrurimin e shtëpisë së parë për persona me aftësi të kufizuara, ku do të strehohen personat me ngecje në zhvillimin mendor, që janë të moshës së rritur dhe nuk kanë përkujdesje nga të afërmit apo familjet e tyre. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka theksuar se kjo shtëpi rezidenciale është



ndërtuar në cilësinë e standardeve të larta dhe tani e tutje do të ofrojë 24 orë

shërbime të ndryshme të pandërprera si: Strehimi, higjiena, ushqimi, shërbime

mjekësore nga stafi profesional, tanimë i rekrutuar, aktivitete të ndryshme sociale, si dhe të gjitha shërbimet e tjera të nevojshme, në bazë të standardeve për shërbime profesionale sociale dhe familjare.

Ndërkaq drejtori i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Islam Thaqi, ka thënë se kapaciteti i kësaj shtëpie, është deri në 14 persona dhe se ekipet e DPMS-së dhe MPMS-së kanë kryer një punë të jashtëzakonshme deri në përfundim të projektit. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Mentor Morina, ka theksuar se MPMS-ja do ta vazhdojë bashkëpunimin e saj me drejtorinë e Komunës së Prizrenit edhe në projekte të tjera.

Kryetari Haskuka ka falënderuar MPMS-në për këtë bashkëinvestim, si dhe spitalin rajonal të Prizrenit dhe Qendrën për Shëndetin Mendor për bashkëpunimin me drejtorinë e Komunës së Prizrenit, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira për personat e strehuar në këtë shtëpi.

## Vendoset gurthemeli për ndërtimin e çerdhes në Drenas

Drenas, 16 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i shoqëruar nga nënkryetari Arben Shala, drejtori i DKA-së, Muhamet Gjoka, drejtoresha e çerdhes "Ardhmëria", Fitore Berisha dhe përfaqësues të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, kanë vënë gurthemelin për ndërtimin e çerdhes në Drenas.

Lladrovci ka falënderuar përfaqësuesit e Zyrës së Bashkimit Evropian për përkrahjen e vazhdueshme për realizimin e projekteve dhe ka shtuar se Komuna e Drenasit është e gatshme të vë në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme për projekte të cilat janë në të mirën e qytetarëve të komunës.

Zyra e Bashkimit Evropian është financuese e ndërtimit të çerdhes e cila do të jetë me standartet më moderne në rajon, ku do të përdoret fjala e fundit e teknologjisë ndërtimore. Vlera e përgjithshme e projektit është rreth një milion euro. Ndërtimi i çerdhes, sipas projektit, parashihet të përfundojë në vitin e ardhshëm.



## Bulliçi nënshkruan marrëveshjen për grantin e performancës komunale



PODUJEVË, 16 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliçi, ka pritur të martën në takim Hamdi Fazliun dhe Ganimete Salihun, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, me të cilët ka nënshkruar marrëveshjen për Grantin e Performancës Komunale.

Marrëveshja e nënshkruar ka për qëllim bashkëpunimin në mes të palëve për pjesëmarrje në Grantin e Performancës Komunale (GPK) për vitin 2021 dhe krijon kornizën për përkrahje financiare me qëllim të ngritjes së performancës komunale. Në bazë të marrëveshjes

trepalëshe MAPL, Komuna e Podujevës dhe Helvetas Swiss Intercooperatinon Kosova, komuna obligohet t'i menaxhojë fondet e marra nga GPK-ja në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë. Komuna, gjithashtu, zotohet se do të ofrojë të dhëna të

sakta në lidhje me çështjet e kërkuara për pjesëmarrje në GPK.

Ky grant bashkëfinancohet nga Qeveria e Kosovës e përfaqësuar nga MAPL, Qeveria e Zvicrës, Qeveria e Suedisë dhe Qeveria e Norvegjisë të përfaqësuar nga HSIK-DEMOS II.

# Mbesin në fuqi masat e njëjta kundër Covid-19

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se do të mbesin në fuqi masat e njëjta kundër Covidit pasi, sipas tij, trendët me pandeminë janë stabile. Pavarësisht kësaj, janë duke u shqyrtuar mundësitë për fillimin e mësimin online në të gjitha nivelet e arsimit. Ndërsa Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur tetë persona të infektuar me Covid. Po ashtu, ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 534 persona dhe janë paraqitur 553 raste të reja me koronavirus



EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 16 MARS** - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka takuar të martën ministrin në detyrë të Shëndetësisë, Armend Zemaj, drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Naser Ramadani, drejtorin e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi dhe zëvendësministrin e Arsimit, Xhavit Rexhaj, me të cilët ka biseduar për gjendjen me pandeminë Covid-19.

Në këtë takim është vendosur që të mbesin në fuqi masat e njëjta kundër Covid-19, pasi që është vlerësuar se trendët janë stabile. Ndërkohë që po shqyrtohen mundësitë për fillimin e mësimin online në të gjitha nivelet e arsimit, për dy javët e ardhshme, duke filluar nga 22 marsi.

Vendimi lidhur me këtë çështje pritet të merret sot pasdite pas takimit të përbashkët të MASH-it, MSh-së, IKShPK-së, SBASHK-ut dhe Këshillit të

Prindërve. Edhe në këtë takim qytetarëve u kërkohet ta respektojnë distancën fizike, t'i përdorin maskat dhe ta mirëmbajnë higjienën personale.

Nga institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të masave kundër Covid-19, që ta ngritin nivelin e angazhimit përmes respektimit rigoroz të masave në fuqi. Pavarësisht prej ngarkesave, institucionet shëndetësore po funksionojnë me kapacitete të plota dhe furnizimi me barna është stabil. Ndërsa Komiteti për Imunizim dhe institucionet përkatëse janë duke i kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme që sapo të arrijë kontingjenti i parë i vaksinës Covax, menjëherë të fillojë vaksinimi i qytetarëve.

**Tetë të vdekur dhe 553 raste të reja me Covid në 24 orët e fundit**

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur

tetë persona të infektuar me Covid. Po ashtu, ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 534 persona dhe janë paraqitur 553 raste të reja me Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 3 649 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 553 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 8 raste të vdekjes

me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Vushtrri 3 raste (87, 80, 76 vjeç), Deçan 1 rast (86 vjeç), Ferizaj 1 rast (71 vjeç), Gjakovë 1 rast (71 vjeç), Lipjan 1 rast (67 vjeç), Mitrovicë 1 rast (62 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 78 380 raste nga 362 186 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 1 723 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 534 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 65 594 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 063", ka njoftuar IKShPK-ja, duke

treguar numrin e rasteve me Covid sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 273 raste, Fushë-Kosovë 32 raste, Prizren 32 raste, Lipjan 28 raste, Podujevë 25 raste, Vushtrri 23 raste, Gjilan 20 raste, Mitrovicë 20 raste, Gjakovë 19 raste, Obiliq 19 raste, Klinë 9 raste, Pejë 8 raste, Kamenicë 7 raste, Drenas 5 raste, Malishevë 5 raste, Graçanicë 4 raste, Junik 4 raste, Rahovec 4 raste, Ferizaj 3 raste, Istog 3 raste, Suharekë 3 raste, Deçan 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Hani i Elezit, Skenderaj dhe Viti 1", ka njoftuar IKShPK-ja.

## Të hënën mbahet seanca konstitutive e Kuvendit, regjistrimi i deputetëve më 17 mars

EPOKA  
ERE **QENDRESA RAMA**

**PRISHTINË, 16 MARS** - Kryesia e Kuvendit e Kosovës, e legjislaturës së tetë, është mbledhur të martën nën drejtimin e kryeparlamentares Vjosa Osmani, për të diskutuar lidhur me përgatitjet për seancën konstitutive të legjislaturës së tetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në mbledhje ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e subjekteve politike parlamentare të legjislaturës së tetë.

Osmani ka bërë me dije se seanca konstitutive e legjislaturës së tetë e Kuvendit do të mbahet më 22 mars, në orën 10:00. Ajo ka njoftuar se seanca do të kryesohet nga



deputeti më i vjetër në moshë, i shoqëruar nga deputeti më i ri.

Pikë e parë e seancës do të jetë formimi i komisionit të

përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve,

për t'u pasuar me betimin e deputetëve.

Senaca konstituive do të përmbyllet me zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Në mbledhjen e kryesisë, po ashtu, u përcaktuan edhe ulëset për grupet parlamentare. Kështu, konform rregullores dhe praktikës së deritashme, grupi më i madh parlamentar (Vetëvendosje) do të ulët në qendër, grupi i dytë me radhë (PDK), në anën e djathtë të kryesuesit të seancës, ndërsa grupi i tretë (LDK), në anën e majtë të kryesuesit. Përcaktimi i ulëseve për grupet e tjera do të bëhet gjatë ditëve në vijim. Kryesia e Kuvendit vendosi gjithashtu që më 17-19 mars të bëhet regjistrimi i deputetëve të legjislaturës së tetë.

# IFC-ja mbështet rimëkëmbjen e sektorit të prodhimtarisë në Ballkanin Perëndimor

Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) do ta lansojë platformën digjitale e cila pritet t'i rrisë lidhjet në mes të kompanive në Ballkanin Perëndimor dhe zinxhirëve rajonalë dhe globalë të vlerave të shtuara. Me këtë rast, Ary Naim, menaxher rajonal i IFC-së për Evropën Qendrore dhe Juglindore, ka thënë se janë duke synuar t'i lidhin ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nga rajoni me zinxhirët globalë dhe rajonalë të vlerave, duke i ndihmuar ato ta përmirësojnë konkurrueshmërinë dhe të rriten më shpejt



**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 16 mars - Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) është duke lansuar platformën digjitale e cila pritet t'i rrisë lidhjet në mes të kompanive në Ballkanin Perëndimor dhe zinxhirëve rajonalë dhe globalë të vlerave të shtuara si pjesë e një përpjekjeje të IFC-së për krijimin e vendeve të punës dhe për mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike të rajonit nga pandemia e Covid-19. Kjo është bërë me dije në një komunikatë për medie dërguar nga IFC-ja. "E implementuar në partneritet me Sekretariatit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), kjo iniciativë është pjesë e një programi këshillues të IFC-së në Serbi, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, i cili pritet ta lehtësojë financimin prej 45 milionë dollarësh amerikanë për kompanitë prodhuese. Këtu përfshihen edhe pesë milionë dollarë amerikanë në investime të huaja direkte dhe mbështetje për t'i rritur vendet e punës me vlerë të shtuar më të lartë. Covid-

19 ka shkaktuar presion mbi prodhuesit në mbarë Ballkanin Perëndimor dhe programi është dizajnuar për të krijuar mundësi të reja për kompanitë, duke shpejtuar rimëkëmbjen nga pandemia", është thënë në komunikatën e IFC-së, duke shtuar se prodhimtaria është sektori i dytë më i madh i punësimit në të gjitha vendet e Evropës Juglindore dhe kontribuuesi i tretë më i madh në bruto prodhimin vendor. "Vlerësohet se prodhimtaria e lehtë siguron vende pune për 200 000 qytetarë vetëm në Serbi dhe mbi 70 për qind e këtij punësimi gjenerohet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)", ka thënë Liliana de Sa Kirchnopf, udhëheqëse e Divizionit të SECO-s për Zhvillim të Sektorit Privat. "Duke promovuar integritimin ekonomik të sektorit të prodhimtarisë të Ballkanit Perëndimor si brenda rajonit ashtu edhe me zinxhirët globalë të vlerave, SECO synon të kontribuojë në krijimin e vendeve më të mira të punës për punëtorët lokalë dhe rritjen e të

hyrave nga shitjet për NVM-të", është shprehur ajo. Gjatë dekadës së fundit, prodhuesit nga Ballkani Perëndimor janë përpjekur të hyjnë në zinxhirët globalë të furnizimit, por jo të gjithë i kanë kapacitetet dhe shkathtësitë për të krijuar lidhje me kompani ndërkombëtare. Platforma e re digjitale që mundëson lidhjen e prodhuesve me investitorët, blerësit dhe furnitorët është duke u zhvilluar së bashku me kompaninë "Achilles", me seli në Mbretërinë e Bashkuar, një furnizues global i platformave të kontraktimit. Programi do të fokusohet te prodhuesit vendorë në një larmi sektorësh, duke përfshirë automjetet, makineritë industriale, makineritë bujqësore dhe prodhimtarinë e lehtë. "Teksa dalim nga kriza e Covid-19, Ballkanit Perëndimor i jepet mundësia të tërheqë investime të reja private, të krijojë vende pune me shkathtësi të larta dhe për t'i rritur të hyrat",

ka thënë Ary Naim, menaxher rajonal i IFC-së për Evropën Qendrore dhe Juglindore. "Me këtë program ne synojmë t'i lidhim ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nga rajoni me zinxhirët globalë dhe rajonalë të vlerave, duke u ndihmuar ta përmirësojnë konkurrueshmërinë dhe të rriten më shpejt", ka thënë ai.

## Rreth IFC-së

IFC-ja është anëtare e grupit të Bankës Botërore. Kjo korporatë është institucioni më i madh zhvillimor global i fokusuar për sektorin privat në tregjet në zhvillim. IFC-ja punon në më shumë se 100 vende, duke përdorur kapitalin, ekspertizën dhe ndikimin tonë për të krijuar tregje dhe mundësi në vendet në zhvillim. Gjatë vitit fiskal 2020 janë investuar 22 miliardë dollarë amerikanë në kompani private dhe institucione financiare në vendet në zhvillim,

duke shfrytëzuar fuqinë e sektorit privat për t'i dhënë fund varfërisë dhe për ta nxitur mirëqenien e përbashkët. Për më shumë informata, vizitoni [www.ifc.org](http://www.ifc.org).

## Rreth SECO-s

SECO-ja është qendra e kompetencave e Zvicrës për të gjitha çështjet thelbësore që lidhen me politikën ekonomike. Bashkëpunimi për zhvillim ekonomik i SECO-s përpiket të arrijë rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe uljen e varfërisë në vendet partnere. Aktivitetet e saj synojnë krijimin e më shumë vendeve pune dhe të tilla më të mira, rritjen e tregtisë dhe konkurrueshmërisë, mbështetjen e institucioneve dhe shërbime efektive, si dhe promovimin e ekonomisë reziliente ndaj klimës. Për më shumë informata, vizitoni [www.seco-cooperation.admin.ch](http://www.seco-cooperation.admin.ch).

## Handikosi paraqet projektin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara



Prishtinë, 16 mars (ER) - Handikosi ka paraqitur të martën aktivitetet e personave me aftësi të kufizuara, të realizuara në kuadër të projektit "Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës përmes prodhimit të strajcave të ripërdorshme si mbrojtje ndaj mjedisit". Drejtori ekzekutiv i Handikosit, Afrim Maliqi, ka folur për rëndësinë e këtij projekti. "Përmes

punimit të këtyre strajcave që janë punuar nga personat me aftësi të kufizuara po ndikohet në mirëqenien e tyre, por edhe në mjedis dhe shëndet", ka thënë ai. Ndërsa përfituesi nga ky projekt, Agon Caka, ka deklaruar se asnjëherë më parë nuk është marrë me rrobaqepësi, por falë këtij projekti ka mësuar edhe në këtë fushë. Ai ka ftuar edhe persona të tjerë që t'u

bashkohen këtyre aktiviteteve. Në anën tjetër Eman Rrahmani, deputet i Kuvendit të Kosovës nga Lëvizja Vetëvendosje, derisa i ka përgëzuar për këtë projekt të Handikos-it, ka thënë se Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës do t'i mbështesin personat me aftësi të kufizuara dhe do të ndihmojnë që të tejkalohet diskriminimi për punësimin dhe i sfidave të kësaj kategorie.



# Qytetarëve u kërkohet të aplikojnë për legalizimin e ndërtimeve

Numri i përgjithshëm i ndërtimeve të legalizuara dhe të regjistruara në kadastër në Komunën e Prishtinës dhe Graçanicës deri në shkurt 2021 është 456. Këto objekte të legalizuara dhe regjistruara arrijnë vlerën nga 72.6 milionë eurosh deri në 96.6 milionë euro, ndërsa objektet e ndërtuara deri në vitin 2004 dhe rastet sociale janë të lira nga taksat të cilat i merr përsipër secila komunë

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 MARS - Qytetarët e Republikës të Kosovës duhet të aplikojnë sa më parë për legalizimin e ndërtimeve të tyre, përndryshe rrezikojnë ndërtimin e objekteve të tyre. Kështu është thënë në forumin virtual për legalizimin e ndërtimeve pa leje të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës (OEAK).

Në këtë forum është thënë se ka një potencial të madh të humbur ekonomik nga pamundësia e shfrytëzimit të pronave të legalizuara, ndërsa është theksuar se pasi të legalizohen dhe regjistrohen në kadastër, ndërtimet pa leje hyjnë në qarkullim zyrtar ekonomik dhe mund të shfrytëzohen për ta lehtësuar qasjen në financa dhe rritjen ekonomike duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Avni Ahmeti nga Agjencia Kadastrale e Kosovës ka thënë se një pronë e palegalizuar nuk mund të regjistrohet në kadastër. Si rezultat i reformave të ndërmarra nga kjo agjenci, Ahmeti ka deklaruar se kanë arritur t'i shmangin procedurat burokratike, teksa ftoi institucionet publike që të veprojnë në përputhshmëri me këto kornizat ligjore që janë në fuqi. Ai përmendi edhe përfitimet nga procesi i legalizimit. "E rëndësishme në këtë fazë është aplikimi për legalizim të objektit, pastaj çështjet teknike dhe pronësore mund të zgjidhen me një fazë të

ardhshme. Mirëpo, nëse nuk aplikon tash automatikisht, e rrezikon ndërtimin që e ke bërë për rrënim. Një pronë e legalizuar dhe e regjistruar në kadastër mund të jetë pjesë e hipotekës, një pronë e legalizuar dhe e regjistruar në kadastër mund të shitet dhe mund të blihet, mund t'i lihet trashëgimtarëve me një akt noterial, por edhe për një pronë për të cilën ne aplikojmë për legalizim ne sigurojmë mosrrënimin e atij objekti. Kështu që inkurajoj të gjithë qytetarët që të shfrytëzojnë këtë mundësi, kjo mundësi nuk vjen dy herë", është shprehur Ahmeti. Për ndërtimet në zona publike, ai ka bërë me dije se edhe këto raste duhet të aplikojnë për legalizim, teksa ka shtuar se kjo ka ardhur si rezultat i keqmenaxhimit të institucioneve, ndërsa për një kohë do të jenë në listë të pritjeve.

Kurse drejtori i Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim, Servet Spahiu, ka thënë se në gjashtëmuorin e fundit ka rritje të interesimit të qytetarëve për legalizim. Ai ka bërë me dije se deri në muajin shkurt në databazën e aplikacionit për legalizim janë regjistruar 3 000 aplikime, teksa ka shtuar se ky numër tashmë mund të sillet rreth 5 000. Më tutje, ai ka thënë se Komuna e Prishtinës dhe ajo e Graçanicës kanë arritur të kenë 465 legalizime të finalizuara, teksa ka shtuar se vlera e tyre arrin shumë prej 72 milionë eurosh deri në 96 milionë euro e të cilat mund të kthehen në treg

dhe të përdoren. "Deri në shkurt janë në regjistër në databazën për legalizim 3 000 aplikacione. Prej këtyre 3 000 aplikacioneve që janë, në bazë të dhënave të fundit del se janë 800 ndërtime që kanë marrë certifikatë të ndërtimit dhe që janë regjistruar në kadastër dhe i kanë kryer të gjitha procedurat, pronarët i kanë marrë certifikatën e legalizimit dhe regjistrimin e pronës. Pjesa tjetër mund të jetë në procedurë, ose mund të jenë në listë të pritjes", ka thënë Spahiu.

Në anën tjetër, drejtori i Urbanizimit në Komunën e Prishtinës, Ardian Olluri, ka deklaruar se procesi i legalizimit nuk është komplet në përputhje me praktikën e funksionimit të organeve administrative, për çka janë angazhuar që së bashku me Agjencinë Kadastrale të Kosovës të tejkalojnë sfidat. Ai ka bërë me dije se kjo komunë ka ndarë në dy kategori objektet që do të aplikojnë për legalizim, duke shtuar se taksa për kategorinë e parë është 1 euro, ndërsa për të dytën 2 euro. "Ne filluam t'i trajtojmë fillimisht objektet e kategorisë së parë për shkak se numri më i madh i objekteve pa leje bie në këtë kategori, por edhe duke marrë parasysh që procesi i trajtimit të këtyre

objekteve është më i thjeshtë, me qëllim që procesi të fillojë shpejt dhe të kemi rezultate të shpejta për të dërguar mesazhe të shpejta te qytetarët, e pastaj të vazhdojmë me kategorinë e dytë, që është pak më e ndërlikuar, por që është duke shkuar mirë", ka thënë ai.

Për të lehtësuar këtë proces, Olluri ka thënë se kanë funksionalizuar aplikacionin për regjistrimin e lëndëve të cilat janë në proces të legalizimit, e që është vegël e komunave për administrimin dhe trajtimin e lëndëve.

Në këtë forum ka marrë pjesë edhe drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka. Ai ka thënë se është i madh potenciali i humbur ekonomik nga pamundësia e shfrytëzimit të pronave të legalizuara, si hipotekë për qasje në financa, dhe për aktivitete afariste dhe investive. "Paqartësitë ligjore, mungesa e planeve rregullative, burokracia e tepruar dhe mungesa e vetëdijesimit lidhur me rëndësinë e një procesi të tillë kanë bërë që ndërtimet e egra të zënë vend anekënd Kosovës. As tentimet e para për trajtimin e ndërtimeve ilegale nuk kanë rezultuar të suksesshme për shkak të procedurave burokratike. Sot situata është ndryshe...

Procedurat për legalizim janë më të thjeshta, e kryerja e një procesi të tillë sjellë përfitime të shumëdimensionale për qytetarët dhe bizneset, duke nisur nga shfrytëzimi i papenguar i të drejtave pronësore, por edhe vënien e këtyre pronave në funksion të zhvillimit ekonomik. Është i madh potenciali i humbur ekonomik nga pamundësia e shfrytëzimit të pronave të legalizuara, si hipotekë për qasje në financa, për aktivitete afariste e investive", ka deklaruar Zeka.

Me ligj të legalizimit, një pronë konsiderohet e legalizuar vetëm kur të regjistrohet në kadastër. Në rastet kur një kompani ndërtuese është shuar apo ka ndryshuar emrin e saj, pronarët e njësive mund të aplikojnë për legalizim të objektit. Objektet e ndërtuara deri në vitin 2004 dhe rastet sociale janë të lira nga taksat, të cilat i merr përsipër komuna. Ndërsa kategoria e parë paguan taksë prej një eurosh për metër katrorë dhe kategoria e dytë paguan taksë 2 euro për metër katrorë. Numri i përgjithshëm i ndërtimeve të legalizuara dhe të regjistruara në kadastër në Komunën e Prishtinës dhe Graçanicës deri në shkurt 2021 është 456, objekte të cilat arrijnë vlerën prej 72.6 milionë eurosh deri në 96.6 milionë euro.

## Transporti, djegiet dhe industria, ndotësit më të mëdhenj të ajrit në Kosovë



PRISHTINË, 16 MARS (ER) - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) ka bërë me dije burimet prej nga më së shumti ndotet ajri në Kosovë. Sipas AMMK-së, në përqindje më të madhe djegiet e vogla si ngrohja nëpër shtëpi, banesa dhe shërbimet e tjera janë ndotësit më të mëdhenj të ajrit. Pastaj, sipas AMMK-së, është industria prodhuese e

energjisë, ajo gurore, ndërsa në fund janë transporti dhe bujqësia. Në tabelën me të dhënat e publikuara nga AMMK-ja është thënë se emetimet e grimcave të ngurta të pluhurit "PM10" bëhen me 49 për qind nga djegiet e vogla, 37 për qind nga industria, 11 për qind nga transporti dhe 3 për qind nga bujqësia. Emetimet e grimcave të ngurta

të pluhurit "PM2.5" më së shumti bëhen nga djegiet e vogla me 68 për qind, pastaj nga industria 24 për qind, transporti 7 për qind dhe bujqësia 1 për qind. Kurse emetimet e dyoksidit të azotit "NO2", bëhen më së shumti nga industria me 57 për qind, transporti 30 për qind, bujqësia 9 për qind dhe djegiet e vogla 4 për qind.

Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (8)

# Shteti shqiptar nuk mund të heshte para ngjarjeve të vitit 1981



**Shkruan: Bedri ISLAMI**

Ishte një periudhë kur, pa lënë mënjanë edhe ndikimin e shtetit, te njerëzit e të gjitha shtresave mori hov zhvillimor ndjenja kombëtare shqiptare. Ndjenjë e cila do të ripërsëritej edhe një herë në vitet e luftës çlirimtare në Kosovë. Nuk mund të mohohet se në fillimin e viteve '80, më shumë se gjithçka, ishte vënë në lëvizje gjithë makineria e shtetit, të gjitha strukturat e tij dhe, pavarësisht faktit nëse kjo bëhej për "patriotizëm demagogjik" apo ishte e konceptuar kështu (çfarë do të trajtohet më tej), kjo pati një rol jashtëzakonisht të ndjeshëm në mentalitetin e kombit.

Ndodhi edhe një fenomen tjetër, i cili, krahas doktrinës zyrtare apo qëndrimit zyrtar, kishte pjesën e tij të ndikimit, në jo pak raste, edhe më të

fuqishëm se vetë shteti.

Në pranverë-vjeshtë të vitit 1981 në të dyja anët e pjesëve shqiptare, në Kosovë dhe në Shqipëri, regjimet e kohës, jo pa paramendim dhe pa ia lënë në dorë kaotizmit dhe spontanitetit, u hodhën njëherësh në veprime gjithçka ata menduan se ishte më e vlefshme dhe më e pranueshme. Megjithatë, në të dyja anët, por në kahe të kundërta, nuk munguan as reagimet spontane të cilat ose nuk ishin planifikuar ose ishin përlogaritur si tjetër gjë.

Regjimi i Beogradit dhe i Prishtinës solli në skenën e re të thyerjes përgjithësisht figura të vjetra politike, të cilat, dashur-padashur, kishin ende ndikim. Mendohej se fjala e tyre do të ishte përfundimtare. Por, tashmë, koha e tyre kishte shkuar.

Njëri pas tjetrit, në mbledhjet e mëdha të diferencimit, filluan të dalin figurat e njohura të Fadil Hoxhës, Veli Devës, Xhavit Nimanit, Sinan Hasanit, një grup gazetarësh të "Rilindja", për të shkuar deri te figura groteske dhe njëkohësisht të përçudtshme, si ajo e Kolë Shirokës. Ky ishte

skalioni i parë, ose "arsenali i rëndë" i betejës së Beogradit përmes Prishtinës. Ndërsa tek skalioni i dytë, i përlogaritur edhe ai, filluan të duken nëpër mbledhjet e gjata, gjithfarë hulumtuesish, sekretarësh, gjurmuesish, hetuesish, gjyqtarësh, për të arritur, si shkrova më sipër, deri tek thirrja patetike e një farë Dushan Ristiçi se "kurrfarë librash nuk na duhen nga Shqipëria". Thirrja e tij, në të vërtetë, nuk ishte asgjë tjetër, veçse pranim i disfatës dhe ankthi për të nesërmen.

Këto figura politike, që u bënë zëdhënës të pushtetit të Beogradit, nuk kishin emër të mirë në Shqipëri. Me të drejtë ata konsideroheshin, ashtu si ishin, zëdhënës të regjimit titist dhe shtypës të popullit të tyre. Duke parë se cilët po dënonin një kërkesë të drejtë, ishte e natyrshme të pasurohej mendimi se të rinjtë e Kosovës duheshin mbështetur.

Në Tiranë ndodhi diçka tjetër. Figurat politike të kohës qëndruan në heshtje. Në fund të fundit, qoftë edhe pa nënshkrim, i pari i tyre kishte

folur, dhe njerëzit e dinin fort mirë se kush qëndronte pas shkrimeve të gjata të "Zëri i Popullit". Zakonisht, kur fliste i pari i tyre, të tjerët heshtnin. Hysni Kapo kishte dy vite që kishte vdekur. Disa muaj më pas, Mehmet Shehut do "i nxirrte koka tym" dhe do të përfundonte në (vet)vrasje, një ngjarje ende e pambyllur. Sidoqoftë, si ka pohuar shumë vite më pas Ramiz Alia, në Byronë Politike, njeriu më i ashpër kundër serbëve, ishte vetë Enver Hoxha. Jo rrallë, shfryrja ose dyshimi i tij rreth gjithçka që lidhej me Beogradin ishte deri në patologjike. Pas besimit të madh që ai kishte pasur tek ta, sidomos deri në tetorin e vitit 1947 kur ata kishin kërkuar zëvendësimin e tij me vllahomaqedonasin Xoxe, gjithçka që do vinte më pas do të lidhej me dyshimin e tij.

Shteti shqiptar, duke i bërë të heshtë drejtuesit e vet, të cilët për hir të së vërtetës, me përjashtimin e dy ose tre vetëve, nuk kishin as aftësitë e duhura për të folur, hodhi në veprim, nëse mund të thuhet kështu, ata që kishin një reputacion të gjerë në Kosovë.

Qoftë mjeshtër të mendimit shkencor, qoftë njerëz të shquar të pendës, apo figura mitike si Çabej e Buda, Dhimitër Shuteriqi, Androkli Kostollari, Arben Puto, Çesk Zadeja, Dalan Shaplo, Luan Omari, Kadare, Agolli, Arapi, Pollo, Jorgaqie Jakov Xoxe. Ndërsa polemika zyrtare nga ana e shtetit shqiptar nuk heshte, angazhohet, njëkohësisht, tërë fuqia intelektuale e vendit, në formë institucionale dhe individuale, që nga zyrat më të larta të shtetit dhe deri tek gazetatat më periferike. Radiotelevizioni i Shqipërisë dhe gazeta "Zëri i Popullit" mbajtën barrën më të madhe. Përballë kryqëzatës serbe, e cila përgjithësisht dhe kryesisht ishte përqendruar tek figurat politike në të gjashtë republikat dhe në dy krahinat e atëhershme, dolën autoritetet më të larta të mendimit dhe këta ishin shumë më të besueshëm se sa të gjithë politikanët e Prishtinës e Beogradit. Ata ishin më të besuar jo vetëm në Shqipërinë londineze, por edhe në Kosovë. —> Është interesante parathënia e





shkurtër e një libri për Kosovën, i cili doli më pas dhe që u nënshkrua, si rrallëherë ose më saktë, si asnjëherë, nga Aleks Buda, Alfred Uçi, Arben Puto, Çesk Zadeja, Dalan Shaplo, Dritero Agolli, Dhimitër Shuteriqi, Ismail Kadare, Luan Omari, Sofokli Lazri, Stefanaq Pollo dhe Zija Xholi, pra të gjithë autoritetet më të rëndësishme shkencore të kohës. Në këtë parathënie, mes të tjerash, do të lexohej: Shkrimet që përmban kjo përmbledhje "Ç'thonë dhe ç'kërkojnë kosovarët" e pasqyrojnë drejtë dramën kosovare.

Ne nuk duam të flasim në emër të intelektualëve kosovarë. Ata dinë ta mbrojnë vetë kauzën e popullit të tyre, dinjitetin e personalitetin e tyre si njerëz dhe si intelektualë. Ata i përkasin një populli, që nuk kërkon mëshirë e lëmoshë. I përkasin një formimi kulturor historik, që i bën të jenë të papërkultur përpara dhunës, shtypjes e arbitraritetit. U përkasin atyre njerëzve, që në kohët e sotme luftojnë për aspiratat më të larta e më të ndritura të popujve, siç janë liria, barazia, demokracia e të drejtat e vërteta njerëzore [...] Nuk kishte ndodhur asnjëherë kjo, por, po ashtu, nuk kishte ndodhur asnjëherë që njerëzit të mos i besonin korifejve të mendimit të tyre. Prandaj edhe gjithçka ishte shumë më e besuar, shumë më e prekshme dhe kaq njerëzore.

Kjo depërtoi tek njerëzit dhe nuk ka lidhje me qëllimet që mund të ketë pasur shteti shqiptar i asaj kohe.

Janë pikërisht ngjarjet e vitit 1981 dhe ndjenjat që u ngjallën atëherë tek njerëzit e zakonshëm, të cilët sollën faktin e madh, që në demonstratat e para madhore të studentëve të dhjetorit 1990, të cilat ishin kundër regjimit dhe kundër sistemit, do të lartësoheshin portretet e Kadaresë dhe të Rexhep Qosjes, si bashkudhëtarë të mendimit dhe, njëkohësisht, të qëndresës.

Nga ana tjetër, do të ishte pikërisht qëndrimi i theksuar atdhetar i intelektualëve shqiptarë të Shqipërisë londineze në mbrojtje të çështjes kombëtare shqiptare në Kosovë, që do u jepte zemër njerëzve që kishin filluar një betejë për të fituar një luftë. Kjo do e bënte, më pas, njërin ndër korifejtë e lëvizjes të vazhdueshme ilegale, Afrim Zhitinë, që jo rastësisht të kishte si emër të luftës pseudonimin "Ismaili" dhe nipit të tij t'i vinte emrin "Dritëro".

Ky ishte reagimi i njerëzve të zakonshëm. Sot, duke paragjykuar gjithçka, mund të thuhet shumë gjëra të ndryshme. Unë e kam përjetuar intensivisht atë kohë, si qytetar dhe si gazetar. Jam, si të thuash, pjesë e dëshmisë që vjen nga poshtë. Nëse dikush, veç fjalëve, do të mund të paraqiste fakte të

vërteta historike, që hedhin poshtë mendimin tim, atëherë, unë do e rishikoja atë. Por unë kam qenë pjesë e demonstrimeve spontane atdhetare të njerëzve të zakonshëm dhe të intelektualëve shqiptarë, për të cilët Kosova ishte e shenjtë. Jo rastësisht, në janarin e vitit 1991, e para organizatë atdhetare që krijohet në qytetin e Shkodrës dhe në të gjithë Shqipërinë, ishte organizata "Kosova" dhe, jo rastësisht, unë isha një ndër themeluesit e saj.

Megjithatë, gjithë çka ndodhur në Shqipëri, për vetë kushtet e sistemit dhe centralizimit, kishte lidhje me shtetin shqiptar. Nuk mund të perceptosh sot se mund të bëhej diçka, qoftë edhe e zakonshme, e të dilte jashtë strukturave të ngritura, që shtriheshin nga selia e Komitetit Qendror dhe deri tek njësitë më të parëndësishme.

Shteti shqiptar nuk mund të heshte para ngjarjeve të vitit 1981. "Përkrahja e shtetit shqiptar për protestat e popullit në Kosovë ishte pjesë e detyrës së tij. Nga kjo detyrë ai nuk mund të shmangej, përveçse duke vënë në dyshim zotimin e vet kombëtar. Ose duke deklaruar dobësinë e pafuqinë e tij," nënvizon studiuesi i njohur Shaban Sinani.

Kjo është edhe e vërteta. Nëse shteti shqiptar do të kishte

heshtur, ai, njëkohësisht, do të kishte humbur edhe çfarëdo lloj vlere në vetë popullin e tij, kur, për më shumë, nuk ishte hera e parë që shteti shqiptar hynte në polemika të tilla me shtetin jugosllav. Megjithëse që nga viti 1974 vërehej një farë heshtjeje në polemika, kishte pasur vite të tjera, të mëhershme, në të cilat shteti shqiptar ishte angazhuar me të gjithë potencialet e tij. Pra, kjo nuk do të ndodhte për herë të parë.

Si është vënë në dukje vitet e fundit, nga disa studiues, në letërsinë politike, jo pa qëllim, e me raste edhe nga shkalla e njohjes apo e përjetimit, është përhapur mendimi se shteti shqiptar i periudhës komuniste dhe vetë Enver Hoxha i shfrytëzuan ngjarjet tronditëse dhe të përgjakura të Kosovës "për të krijuar vlerat e një patriotizmi demagogjik ose të një patriotizmi të rremë".

Mund të ketë qenë kështu. Askush nuk mund të futej në mendjen e një njeriu që, duke qeverisur me dorë të hekurt, ishte krejt i mbyllur, si një enigmë e pazgjidhur kurrë. Sidoqoftë, ka shumë gjëra që duhen parë qetësisht.

Ka të paktën dy arsye të rëndësishme për të besuar se e gjithë ajo, që u ngrit dhe u bë gjatë vitit 1981 dhe më pas, nuk kishte qenë një shfaqje e rremë patriotizmi. Së pari, është rasti të krahasohet përmbajtja e debateve publike të shtetit shqiptar me

pjesën e pashfaqur të kësaj polemike, e cila gjendet kryesisht në ditarët e Enver Hoxhës dhe në protokollet e mbledhjeve të Byrosë Politike. Nga ky krahasim del se udhëheqja e lartë e shtetit komunist, edhe në bisedat e brendshme, si në mbledhjet e Byrosë apo të Sekretariatit të Komitetit Qendror, ka diskutuar me të njëjtat teza. Nuk mund të besohet se kjo udhëheqje ka dashur ti bëjë edukatë patriotike vetes, apo të krijojë patriotizëm demagogjik për veten.

Së dyti, pikërisht në këtë periudhë shteti shqiptar e merr shumë seriozisht konfliktin për Kosovën dhe ndërmer veprime në fushën diplomatike. Kësaj periudhe i përket nisma e E. Hoxhës për të zbutur tensionet me fqinjët jugorë, ndërsa viziton Shqipërinë një nga figurat më të njohura të politikës gjermane, Shtraus. Asokohe, Gjermania kishte të njëjtin problem si Shqipëria, ndarjen e vet. Ndonëse ndarja kishte ndodhur më vonë, bashkimi shihej si një mundësi më e largët. Sidoqoftë, politikanët gjermanë e kishin të domosdoshëm një precedent të tillë në Europë, pra një ndryshim të kufijve të pasluftës së Dytë Botërore. Kjo do të përbënte një lehtësi të rëndësishme për ta. Askund tjetër nuk mund të krijohej një precedent i tillë më lehtë se në rastin shqiptar.

(Vijon)

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Vëllaznimi kërkon pikët e shpresës ndaj Bashkimit

**PRISHTINË, 16 MARS** - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e 24-t në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Sfida e parë do të jetë ndërmjet Vëllaznimit dhe Bashkimit, që do të jetë shumë e rëndësishme për të dy skuadrat. "Kuqezinjtë" ndodhen në vendin e fundit me 30 pikë, por nuk janë dorëzuar për të mos rënë nga elita, ndërsa prizrenasit kanë grumbulluar tri pikë më shumë. Takim interesant pritet edhe ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Rahovecit në kryeqytet. "Bardhekaltrit" deri më tani kanë 32 pikë, kurse "Vreshtarët" renditen në vendin e tretë me 37 pikë. Golden Eagle Ylli, që ndodhet në vendin e dytë me 38 pikë, do të përballet me Trepçën, që ka 32 pikë. Të dyja skuadrat kanë synime të ndryshme në këtë edicion dhe fitorja është e rëndësishme për të dyja palët.

Ylli konsiderohet favorit, por mitrovicasit kanë treguar formë të lartë në stinorin pranveror, andaj pritet një ndeshje interesante. Peja - Ponte Prizreni është përballja e fundit për këtë xhiro. Pejanët nuk janë në formë të mirë në ndeshjet e fundit, kurse e kundërta është për prizrenasit që janë liderë dhe ndodhen në formë shumë të mirë. "Verdhezinjtë" janë në vendin e katërt me 35 pikë, kurse Ponte në vendin e parë me 39.

**FIVE STAR Superliga - Java 24**

**Të mërkurën takohen:**  
16:00 Vëllaznimi - Bashkimi  
18:00 Sigal Prishtina - Rahoveci

**Të enjten takohen:**  
16:00 Golden Eagle Ylli - Trepça  
18:00 Peja - Ponte Prizreni



## Atletico për përmbysje kundër Chelseat, Bayerni pret të konfirmohet në çerekfinale

**MÜNCHEN, 16 MARS** - Bayern Muncheni pret sonte (e mërkurë) të kualifikohet në çerekfinalen e Ligës së Kampionëve kur e pret Lazion në ndeshjen kthyesë. Në fakt, klubi gjerman e fitoi ndeshjen e parë në "Olimpico" me rezultat 1-4 dhe tash është afër arritjes së synimit, derisa për Lazion duket e vështirë ta arrijë kualifikimin në fazën ku nuk e ka shijuar që nga viti 2000. Bayerni po në fundjavë arriti fitore ndaj Werder Bremenit (3-1) në Bundesliga dhe tash e pret i qetë ndeshjen ndaj klubit nga kryeqyteti. Lazio është e fokusuar në Serinë A, ku është vërtetuar edhe nga drejtori sportiv i kësaj skuadre, Igli Tare, i cili pranoi se ndeshja e së premtes në Serinë A kundër Crotones vlen më shumë se ajo kundër Bayernit, për faktin se Lazio synon të sigurojë një vend në Ligën e Kampionëve. Vendësit në këtë ndeshje do të



**TË MËRKURËN TAKOHEN:**  
Bayern Munchen - Lazio (4-1)  
Chelsea - Atletico Madrid (1-0)

jenë pa Corentin Tolisson, Douglas Costan dhe Tanguy Nianzoun, kurse mysafirët kanë mungesën e Manuel Lazzarit dhe Luis Felipe. Ndeshje më

interesante pritet të jetë ajo që zhvillohet në Londër në mes të Chelseat dhe Atletico Madridit. Skuadra angleze e fitoi ndeshjen e parë me rezultat 0-1 dhe tash e

ka epërsinë e terrenit vendës, por spanjollët që po kryesojnë në La Liga do të përpiqen ta përmbysin rezultatin dhe të kualifikohen në çerekfinale.



### Caktohen çiftet çerekfinaliste të hendbollistët

**PRISHTINË, 16 MARS** - Besa Famgas është favorite e madhe për të kaluar në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Shorti i tërhequr të martën ka përcaktuar që Besa Famgas të takohet në udhëtim me Prizrenin. Në ndeshjet e tjera mund të ketë më tepër rivalitet. Drenica e pret Kastriotin, kurse Trepça e Vushtrria takohen në Mitrovicë. Dy skuadrat e tjera me traditë, Vëllaznimi dhe Prishtina, luajnë në Gjakovë. Ndeshjet çerekfinale luhen më 24 e 25 mars.

### Çerekfinalja e Kupës, sot zhvillohen dy ndeshje

**PRISHTINË, 16 MARS** - Kupa e Kosovës në futboll rikthehet këtë mesjavë me katër ndeshje çerekfinale. Gara është mjaft e fortë, derisa pjesë e kësaj faze janë pesë ekipe të Superligës dhe tri të Ligës së Parë. Ndeshja më e fortë pritet të jetë

ajo në mes të Feronikelit dhe Prishtinës që zhvillohet në "Rexhep Rexhepi". Interesante do të jetë edhe përballja në mes të Dukagjinit të Klinës dhe Drenicës nga Skenderaj. Ndërsa nesër (e enjte) do të zhvillohen dy ndeshje.

Istogu pret A&N, ndërsa Trepça '89 pret Llapin. Të mërkurën në çerekfinale të Kupës takohen: Feronkeli-Prishtina dhe Dukagjini-Drenica, kurse të enjten takohen: Istogu-A&N dhe Trepça '89-Llapi.



## ESPN ultimatum Joshua e Fury: 30 ditë kohë për ta caktuar datën dhe vendin

**BRISTOL, 16 MARS** - Pak orë pas deklaratës së promotorit të njohur të boksit Eddie Hearn, se dy boksierët britanikë Anthony Joshua e Tyson Fury kanë firmosur kontratën, televizioni ESPN u ka lëshuar një ultimatum dy boksierëve dhe stafëve të tyre. ESPN, që do të

transmetojë "live" dhe me pagesë këtë sfidë, ka kërkuar që brenda 30 ditësh të jenë zyrtarizuar të gjitha detajet në lidhje me vendin dhe datën se kur do të zhvillohet sfida. Në të kundërt, dy boksierët t'i thonë "lamtumirë" kësaj përballje. Sipas Hearn, ofertat për

zhvillimin e kësaj sfide kanë ardhur nga disa shtete, kryesisht nga Lindja e Mesme, Azia, Evropa Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në total do të zhvillohen dy duele, e para me shumë gjasa në qershor dhe e dyta në fund të këtij viti. "Ne presim që palët ta

zyrtarizojnë datën dhe vendin. Kanë afat 30 ditë për ta bërë këtë gjë. Fansat duan duelin dhe jo fjalët. Tashmë që palët kanë firmosur kontratat, një muaj për ta përcaktuar vendin dhe datën janë të mjaftueshme", u shpreh Gareth Davies, një nga drejtuesit e ESPN.



## Berisha: FC 'Malisheva' e ka bërë krenare Komunën e Malishevës

**MALISHEVË, 16 MARS** - Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Mazreku, të martën kanë pritur në një takim trajnerin e FC "Malisheva", Arsim Thaçi, stafin drejtues dhe disa nga lojtarët, të cilët i kanë falënderuar me punën e ekipit dhe për t'i përkrahur drejt arritjes së qëllimit të ekipit për inkuadrim në Superligën e Kosovës në futboll.

"Në emër të Komunës së Malishevës dhe të kryetarit Begaj, ju shpreh mirënjohje dhe falënderim për punën që po bëni si ekip në tërësi. Përveç lojës së mirë dhe rezultateve, ju po tregoni edhe kulturë të lartë jo vetëm sportive, dhe jeni duke bërë krenare një komunë të tërë", i ka thënë nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, delegacionit të ekipi të FC "Malisheva", si dhe u ka



uruar suksese të mëtutjeshme në kampionat dhe drejt arritjes së qëllimit, për t'u inkuadruar në Superligën e Kosovës në Futboll, aty ku edhe e meritojnë si klub.

Nga ana vjetër, trajneri i FC "Malisheva", Arsim Thaçi, ka thënë se si ekip, së bashku me të gjithë stafin drejtues, trajnerët ndihmës dhe të gjithë lojtarët,

qëllim e kanë marrjen e titullit kampion dhe inkuadrimin në Superligë. "Jemi shumë të motivuar dhe jemi duke dhënë maksimumin e mundshëm, por me disiplinë, për ta arritur qëllimin tonë, që të bëhemi kampionë dhe të ngitemi në nivelin më të lartë të garave, në Superligë", ka thënë trajneri Thaçi.

## Lakersat fitojnë derbin ndaj Golden State



**LOS ANGELES, 16 MARS** - Ka përfunduar një tjetër xhiro në NBA, ku disa përballje ishin spektakolare. Derbi i kësaj jave ishte ai në mes të Golden State Warriorsit dhe Los Angeles Lakersit, që përfundoi me fitoren e këtyre të fundit 128-97. Një fitore më të vështirë mori Charlotte Hornets që

mposhti Sacramento Kings me rezultat 122-116. Triumf spektakolar mori Milwaukee Bucks ndaj Washington Wizardsit me shifrat 133-122. Tjetër përballje interesant doli të ishte edhe ajo e Brooklyn Netsit që fitoi 117-113 ndaj New York Knicks. Fitore të vështirë në këtë rreth mori

edhe San Antonio Spurs si mysafir i Detroit Pistonsit 109-99. Me të njëjtin rezultat (109-99) përfundoi edhe ballafaqimi në mes të Los Angeles Clippersit që fitoi si mysafir i Dallas Mavericksit. Në anën tjetër, fitore më komode mori Phoenix Suns ndaj Memphis Grizzliesit me shifrat 122-99.

### SHKURT

#### Fazliji ftohet nga Kosova

Klubi i St. Gallenit ka konfirmuar ftesën e Përfaqësueses së Kosovës për mbrojtësin Betim Fazliji. Faziliji ishte lojtari që vitin e kaluar u largua nga Zvicra dhe veshi fanellën e "dardanëve". Klubi zviceran njoftoi se Fazliji ka pranuar ftesën e Kosovës për tri ndeshjet e muajit mars, ndaj Lituaniës, Suedisë dhe Spanjës. Ndeshja e parë është miqësore, kurse dy të tjerat janë kualifikuese për botëror.

#### Ibra rikthehet në Kombëtaren e Suedisë

Suedia ka bërë publike listën e lojtarëve të ftuar për ndeshjet e muajit mars. Suedezët do të përballen me Gjeorgjinë dhe Kosovën në kuadër të kualifikimeve për Botëror, derisa do të zhvillojnë edhe një ndeshje miqësore ndaj Estonisë. Zlatan Ibrahimović është rikthyer edhe zyrtarisht në Kombëtaren e Suedisë dhe do të jetë i pranishëm në ndeshjen ndaj "dardanëve" në stadiumin "Fadil Vokrri".

#### D'Amrbsion rezulton pozitiv me Covid

Mbrojtësi i Interit, Danilo D'Amrbsion, ka rezultuar pozitiv me Covid-19 dhe është karantinuar menjëherë, duke u shkëputur nga pjesa tjetër e skuadrës. D'Amrbsio ndjeu shqetësime që pas sfidës ndaj Torinos dhe shkaku ka qenë pikërisht infektimi me koronavirus. Tashmë të gjithë futbollistët do t'u nënshtrohen tamponëve, ndërkohë që D'Ambrosio do ta humbasë ndeshjen e ardhshme në kampionat ndaj Sassuolos, ndërkohë që mund të përfitojë nga ndalesa e kombëtareve për t'u kthyer në dispozicion të Contes në fillim të muajit prill.

#### Dortmundi nxjerr në shitje Haalandin

Erling Haaland mbetet një nga emrat më të lakuar në tregun e transferimeve, një sulmues për të cilin interesohen një pjesë e mirë e ekipeve evropiane. Fillimisht u përfol se biondi norvegjez nuk ishte në shitje, por përballë një presioni shumë të madh edhe drejtuesit e Borussia Dortmundit duken të dorëzuar. Sipas të përditshmes gjermane "Bild", verdhezinjtë kanë vendosur të lënë të lirë Haalandin, por jo pa marrë fillimisht atë që kërkojnë. Dortmundi për yllin e saj kërkon minimalisht 150 milionë euro. Për Haalandin prej kohësh janë vënë në garë ekipi si Real Madridi, Barcelona, Manchester City dhe Bayern Munchen.

#### Honda përfundon në Azerbajxhan

Nis një etapë e re për një nga futbollistët më të famshëm japonezë, Keisuke Honda. Tashmë në moshën 34-vjeçare, ish-futbollisti i Milanit ka nënshkruar me Neftchi Baku në kampionatin e Azerbajxhanit. Që pas largimit nga kuqezinjtë në vitin 2017, Honda ka luajtur me katër skuadra të ndryshme: Pachuca, Melbourne Victory, Vitesse dhe Botafogo. Me ekipin e njohur brazilian është aktivizuar në 18 ndeshje të kampionatit dhe ka realizuar dy gola gjatë vitit 2020.

#### Neueri i pathyeshëm, Nubeli, kërkon largimin nga Bayerni

Alexander Nubeli ka kërkuar largimin nga Bayern Muncheni. Manuel Neueri është titullar i padiskutueshëm mes shtyllave të Bayernit, ka bërë që ish-portieri i Schalke 04 t'u kërkojë drejtuesve largimin nga skuadra. Shtëpia e re e Nubeli mund të jetë Monaco, që drejtohet nga ish-trajneri i gjermanëve, Niko Kovaç. Është pikërisht trajneri kroat ai që e kërkon futbollistin të transferohet në Ligën 1. Sipas raportimeve të mediave, Bayerni mund ta lëshojë Nubelin vetëm në formë huazimi pa të drejtë blerjeje, pasi ai konsiderohet pasardhës i Neuerit.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**



ISBN 978-9951-780-37-7

9 789951 780377

ÇMIMI: 5.99 €




AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.



ISBN 978-9951-780-10-0

9 789951 780100


4<sup>99</sup> €

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





Kryetari i Komunës 01-nr.465-17916, Dt. 15.03.2021 - Suharekë

Ne bazë të nenit 4, nenit 10 të Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03/L-139 dt. 26 mars 2009 të Republikës së Kosovës dhe Ndryshim plotësimi i Ligjit mbi shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr.03/L-205 dt. 10 dhjetor 2010, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative O/L-031, dhe bazuar në Vendimin Nr. 01 nr.465-58705, dt.08.12.2020 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, brenda afatit ligjor, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë :

#### VENDIM PRELIMINAR

(Për ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

**I. MIRATOHET** Kërkesa e subjektit kërkuës, Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës, për shpronësimin e pronës private të pronarve dhe zotuesve të interesit, për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në Suharekë e cila gjindet në ngastrën kadastrale me nr. P-72116046-02816-4, në sip. prej: 51 m<sup>2</sup> dhe ngastrën kadastrale me nr.P-72116046-02816-7, në sip. prej :1060 m<sup>2</sup>, e evidentuara në emër të **Muhamet (Xhemajli) Elshani, Zk. Suharekë.**

**II.** Vërtetohet se ndërtimi i rrugës publike në Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluajtshmerisë së lartëcekur është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes e këtij qëllimi.

**III.** Zotuesi i interesit të pronës se cekur në pikën 1. të këtij Vendimi do të kompenzohet konform dispozitave në fuqi të Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme.

**IV.** Vendimin Preliminar, brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit të tij, Organi shpronësues do të ia dergon, zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se u takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar, bazuar në nenin 10 paragrafi 3 të këtij Ligji.

**V.** Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, Organi shpronësues e shpall Vendimin në një gazetë zyrtare me tirazh me të madhë në Kosovë, ndërsa ky vendim hynë në fuqi ditën e shpalljes në këtë Gazetë

#### Arsyetim

Subjekti kërkuës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë të Komunës së Suharekës, me kërkesën nr. 01-104-48631, datë 12.10.2020 iu ka drejtuar Kryetarit të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike Suharekë. Këtë shpronësimi i ka paraprirë edhe Vendimi i Kuvendit të Komunës së Suharekës 01-Nr-016-53056 të dt.30.10.2020 me të cilën paluajtshmeria e evidentuar në pikën 1. të dispozitivitë shpallet interesit të përgjithshëm publik.

Subjekti kërkuës, kërkesës për shpronësim ia ka bashkangjitur dokumentacionin përkatës konform nenit 8, lidhur me nenin 4. të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës konkludon se shpronësimi i paluajtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv të këtij Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtij qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës së paluajtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji .

Organi shpronësues-Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluajtshmerisë Nr. 01 nr.465-58705, dt.08.12.2020 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkuës-Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në Suharekë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkuës është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzime Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendrike pas datës se hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtrohet i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtrohet i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejtë të dorëzojë në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:

Subjektit kërkuës

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit



Kompania Regjionale e Mbeturine K.R.M."Uniteti"SH.A.

### NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

**Kompania Regjionale e Mbeturine "Uniteti" Sh.A zgjatë afatit edhe për shtatë (7) ditë kalendrike për aplikim të kandidatëve për pozitën :**

**Një (1) Punëtor Sigurimi - KRM "Uniteti"Sh.A - i Konkursit të shpallur me datë 12.02.2021**

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **16.03.2021**, deri me date **23.03.2021** ora 16:00.

**Vërejtje:** Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ardita Hamdush Hyseni, shpall të pavlefshme Licencën e Punës, KO-20617-05-20. data 01.04.2015.

► Abdylbari Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Hasan Rexhaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VII shfmu " Heronjë e Kabashit " Korish.

► Erzen Ademaj shpall të pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Edona Hamiti shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLM " Dr. Xheladin Deda".

► Gzim Salja shpalle të pavlefshme dëftesat e vitit I,II të SHMLE " Hasan Prishtina".

► Ali Xhigoli shpalle të pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani"

► "Matoshi 99 O.P." shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70676656. Nr. UNIK 811195529, nr. fisk. 600499108.

► "Rembek" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330349888.

► Auto Shkolla "Baza-L" vazhdon ofertën me 50% zbritje deri më 20.03.2021. Gjilan.

► Jap banesë me qira afër 60 m<sup>2</sup>, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m<sup>2</sup>, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m<sup>2</sup> dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m<sup>2</sup>, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

